



Funded by the
European Union



Regional Network
for Cultural Diversity

Projekti "Rrjeti Rajonal për Diversitet Kulturor"

Thirrje për aplikime 2020

Thirrje e Hapur 1 "Mbështetje e projekteve shumëgjuhësore në pesë shtete"

Data e shpalljes: 23.12.2020

Rrjeti Rajonal për Diversitet Kulturor - READ është projekti rajonal i financuar nga Bashkimi Evropian me qëllim që t'u mundësojë akterëve të shoqërisë civile të nxisin dhe ti kontribuojnë tolerancës ndërkulturore dhe vlerave demokratike me fokus të veçantë tek të rinjtë. Projekti implementohet nga Goethe-Institut Shkup së bashku me organizatat e saj partnere: Asociacioni Krokodil (Serbi), Qendra për Bashkëpunimi Ballkanik - Loja (Maqedonia e Veriut), Instituti I Librit dhe i Promocionit (Shqipëri), Asociacioni Kulturor Kalem (Turqi) dhe Qendra Multimedia (Kosovë).

Projekti filloi më 1 shtator 2020 dhe do të zgjasë deri më 31 gusht, 2024. Buxheti i disponueshëm për grante është 80.000 € në total për tre raunde thirrjesh për projekte gjatë tri vitesh. Për thirrjen e parë buxheti në dispozicion është 28,000 €.

Thirrja e Hapur 1 "Mbështetja e projekteve shumëgjuhësore në pesë shtete", synon të mbështesë difuzionin e veprave letrare në shtetet në fokus. Qëllimi i kësaj përpjekjeje pritet të jetë përkthimi në kombinim prezantimin e promovimin e letërsisë në rajon. Mbështetja e këtij projekti do të plotësojë dhe do të rrisë ndjeshëm përkthimin ndër-rajon të autorëve nga Ballkani Perëndimor dhe Turqia.

Afati i fundit për aplikim: 10 shkurt, 2021, ora 00:00, koha lokale

Shuma maksimale e mbështetjes për këtë thirrje është 2.000 € për grant. Kjo shumë do të mbulojë kostot që ndërlidhen me përkthim, dizajn dhe shtyp si dhe promovimin e letërsisë në rajon. Mbështetje e projekteve shumëgjuhësore nënkupton dhënien e 12-15 granteve të vogla për OSHC-të nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Serbia dhe Turqia (objektivi është afërsisht 2-3 grante për çdo vend).

Veprat në gjuhë origjinale nga vendet e pranuar në këtë thirrje duhet të përkthehen në gjuhë të tjetër të vendeve të përfshira në thirrje (P.sh. Një autor turk duhet të përkthehet në gjuhët shqipe, serbe dhe maqedonase).

Të gjitha aplikacionet duhet të dorëzohen në mënyrë elektronike përmes Portalit të Aplikimit





Funded by the
European Union



**Regional Network
for Cultural Diversity**

Goethe-GAP në gjuhën Angleze: <https://kulturfoerderung.goethe.de/r.aspx?q=Ct9PbAFZ>, me mundësi për të përmbushur përshkrimin e hollësishëm të projektit në gjuhët lokale - shqipe, serbe, maqedonase ose turke.

Të gjitha dokumentet e nevojshme për këtë thirrje mund të gjenden në portalin GAP.

Aplikantët duhet të jenë:

- Jo-fitimprurëse;
- Organizata të shoqërisë civile;
- Drejtpërdrejt përgjegjëse për përgatitjen dhe menaxhimin e projektit me bashkë-aplikantët;
- Të regjistruar në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni të Veriut, Serbi ose Turqi për të paktën 6 muaj para datës së publikimit të thirrjes;
- Punojnë në një ose më shumë nga fushat tematike me rëndësi të kësaj Thirrje për Propozime.

Vetëm një kërkesë nga secili aplikant do të merret në konsideratë.

Çfarëdo pyetje rreth procesit të aplikimit mund të dërgohet në adresat e organizatave partnere në adresat vijuese:

Për Shqipëri: instituti.libri.promocioni@gmail.com , për Kosovë: arif@gendra.org, për Maqedoninë e Veriut: lojaculture@gmail.com , për Serbi: office@krokodil.rs, dhe për Turqi: info@itef.com.tr.

Për çfarëdo pyetje rreth procesit të aplikimit nëpërmjet portalit, apo çështjeve administrative e financiare, ju mund të na kontaktoni në adresën: read-grants@goethe.de

Ju lutem të na ndiqni në profilet tona në [Facebook](#) dhe [Instagram](#) për më shumë informata rreth projektit.

